- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [**Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in**]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*], përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

-
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: Bashkelidhur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

PARAQITJA, FORMA, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE PËRSHKRIMI I UNIFORMËS SË POLICISË BASHKIAKE

1. UNIFORMA SHËRBIMI DIMËRORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapelë, këpucë).



Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë blu e errët. Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, perberja: 65% poliestër dhe 35% viskoze ($\pm 5\%$). Pësia: 270 ± 10 gr/m², me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë.



Pantallonat, njëloj me xhaketën ngjyrë **blu e errët**. Perberja: 65% poliestër dhe 35% viskoze ($\pm 5\%$), Pësia: 270 ± 10 gr/m². Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje.



Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta përmontimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit.

Ngjyra	E kaltër	
Përbërja %	80 % pambuk(± 5%)	20 % poliestër (± 5%)
Thurja	Tafta 1.1	
Masa gr/m ² (± 5 %)	135 gr/m ²	
Hollësia e fijes (± 5 %)	baza 80/2	indi 80/2
Dendësia/10mm ± 2	Baza 45/10mm	Indi 25/10mm
Qendrushmeria ne terheqje	Baza ≥ 500N	Indi ≥ 400N
Qendrushmeria ne grisje	Baza ≥ 15N	Indi ≥ 20N
Zgjatimi ne terheqje	Baza ≥ 10%	Indi ≥ 24%
Stabiliteti dimensional i larjes 40 ° C	Baza ≤ 0.5%	Indi ≤ 0.5%
Kapaciteti i prishjes (stadi fillestar)	Baza ≥ 100°	Indi ≥ 135 °
Kapaciteti i prishjes (pas 25 cikle ne larje 40 °)	Baza ≥ 95 °	Indi ≥ 130 °
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4—5 (Shkalla Gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Pershkushmeria e ajrit	≥ 235 mm/s	
Kapacitetit perthithes	≥ 100%	Pas 25 larje ≥ 120%
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 20000 cikle	
Fortesia ne tretesiren e hipoclorit	Degradimi ≥ 4	
Qendrushmeria e ngjyres ne hekurosje	Degradimi 5 Shkarkimi ≥ 4-5	

Efekti pilling (kokërrzimi)	≥ 4—5
AZO Ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem
pH	4.0 - 7.5



Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi max. 7–8 cm.

Ngjyra	Blu e errët	
Përbërja %	100 % poliester	
Thurja	diagonal 2/1	
Masa gr/m ² (± 5 %)	110 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4-5 (Shkalla gri)	ngjyrosja duhet të jetë në fije
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 10000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4-5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	



Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të bardhë përpara dhe me kopsa si të xhakëtës. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë. Ky model do të jetë për punonjësit meshkuj. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit **Kapela e uniformës për meshkuj** duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët	
Përbërja ($\pm 5\%$)	50% pambuk	50% poliester
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Pesha ($\pm 5\%$)	200 - 220 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4□5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4□5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	



Pamja anash



Pamja përpara



Pamja anash

Këpucë uniforme ngjyrë e zezë dhe me lidhëse.

Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit Këpucë duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Materialet*				
Lëkura	Lloji	Lëkurë viçi ose ekuivalente me faqe natyrale		
	Ngjyra	e zezë		
	Trajtimi	me anilinë		
	Trashësia	1.4 – 1.6 mm		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit		$\geq 5.0 \text{ mg/cm}^2\text{h}$	
	Regjia	kromike	kromi VI	$\leq 3.0 \text{ mg/kg}$
	Rezistenca në grisje		$\geq 120 \text{ N}$	
	Rezistenca në përkulje		në të thatë	asnjë dëmtim pas $\geq 50\,000$ përkuljesh
			në të njomë	asnjë dëmtim pas $\geq 15\,000$ përkuljesh
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		në dritë	4-5 (shkalla blu)
			në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)
pH		3.5-7.5		
Azo ngjyrues		Nuk duhet të jenë të pranishëm		



Pulovër blu e errët golf me zinxhir. Ka përf forcime doku në bërryla dhe supe, me spaleta doku. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit.

Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët
Përbërja % ($\pm 4\%$)	50% Lesh	50% Akrilik
Thurja (*trupi; **jaka)	materiali 1*	Interlock
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Hollesia e fijes ($\pm 4\%$)	70 tex2c	
Masa gr/m ²	650+- 25 gr/m ²	



Xhup blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë ngjyrë blu e errët së bashku me jakën. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.

Xhup dimeror , pjesa e sipërme të mos depertoje shiun dhe eren, të sigurojë mbrojtje të gjithanshme ndaj kushteve të motit. ,

Peshe 190 \pm 10 gr/m², 100% poliester poliuretano, astar i brendshëm 100% polyester 120 \pm 10 gr/m² me imbotiture; kapuc i levizshëm i cili mund të pershtatet lehtësisht dhe të kycet të këto mundësi pershtatjeje;

Xhupi duhet të jetë blu në të errët.

Ngjyra	Blu e errët
Përbërja %	100 % poliestër
Thurja	Diagonal 2/2
Masa gr/m ² % (± %)	250 - 300 gr/m ²

Mbrojtje e gjithanshme ndaj kushteve të motit. Sipas normative SSH/EN 342:2017; SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3,ose ekuivalente, SSH/ EN ISO 13688/2013. CERTIFIKIMI

Te jene me logo “POLICIA BASHKIAKE” .

Pamja përpara



Pamja prapa

Xhiboks blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë një pjesë ngjyrë blu e errët dhe pjesa tjetër e kaltër. Jaka është blu e errët. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.

Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Pamja përpara



Pamja prapa

Këpucë me qafa ngjyrë e zezë, me lidhëse. Këto shërbejnë edhe për stërvitje. 1. SYPRINA DHE INSERTET : Lëkurë viçi e plotë e zezë

2. AKSESORËT:

Filato – për faqen e nailonit titulli tex 30x2 për gjilpërë, për astar (spola) nailon titulli tex 40x2; me ngjyrë të njejtë me këpucën për qepjet e dukshme në siprinë, me ngjyrë të njejtë me atë të astarit për qepjet e dukshme në astar.

Filato – për qepje “blake” në nailon titulli tex 1.0;

Thumbat – prej hekuri të përdorur për montimin e thembrës.

Ngjitësit – duhet të jenë tip dhe cilësi nga më të mirët në treg, jo dëmtues dhe të përshtatshëm në përdorim.

Materialet*				
Lëkura	Lloji	Lëkurë viçi ose ekuivalente me faqe natyrale		
	Ngjyra	e zezë		
	Trajtimi	me anilinë		
	Trashësia	1.8 - 2.0 mm		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 5.0 mg/cm ² h		
	Regjia	kromike	kromi VI	□ 3.0mg/kg
	Rezistenca në grisje	≥ 120 N		
	Rezistenca në përkulje	në të thatë	asnjë dëmtim pas ≥50 000 përkuljesh	
		në të njomë	asnjë dëmtim pas ≥15 000 përkuljesh	
	Qëndrueshmëria engjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)	
në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë		4-5 (shkalla gri)		
pH	3.5 -7.5			
Azo ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem			



Bluzë e brendshme dimri e trikotuar, ngjyrë e zezë, me jakë rrethore. Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset stema e bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Ky model shërben edhe për stërvitje.

Ngjyra (*trupi dhe **jaka)	Ngjyre e zeze	
	Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% pambuk	
Thurja (*trupi dhe **jaka)	materiali 1*	Jersey (e lëmuar)
	materiali 2**	Llastik 1:1
Masa gr/m ² (*trupi dhe **jaka) (± 5%)	materiali 1*	180 gr/m ²
	materiali 2**	280 gr/m ²
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4—5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4—5	
AZO ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishem	
pH	4.0 - 7.5	



Pamja përpara



Pamja prapa

Bluzë me mëngë të gjata ngjyrë blu e errët, e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit **Bluzë me mëngë të gjata polo** duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	blu e errët
	materiali 2**	blu e errët

Përbërja %	85 - 90% pambuk	10-15% polipropilen
Thurja (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës)	materiali 1*	pique (syth irlandez)
	materiali 2**	punim llastik 1:1
Hollësia e fijos	Fibra pambuku	70/1 Nm +-5Nm
	Fibra polipropileni	65 x 1 dtex +-5 dtex
Masa gr/m ² (*trupi; **jaka dhe bordura e mëngës) (± 5%)	materiali 1*	150 -170 gr/m ²
	materiali 2**	660 gr/m ²



Pelerina e shiut është me ngjyrë të zezë. Pelerine shiu me shirita reflektive duke përdorur pëlhurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht

i papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të sigurt, si dhe unaza dhe carje shpinën e pasme për të shtuar ajrosjen.

Pëlhurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluar për të ndaluar penetrimin e ujit

Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe

Shirit reflektues për më shumë dukshmëri

Hapje me zinxhire para

2 xhepa për hapsirë të sigurtë

Kapuç që paloset nën jakë


Mëngë elastike nga brenda

Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati

Sipërfaqja e pëlhurës është ekstremisht ujë resistuese, duke e shpërndarë ujin nga sipërfaqja e pëlhurës.

Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngën e majtë.

Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g

Ngjyra	E zeze	
Përbërja%	100% poliamid	
Thurja	Oxford	
Masagr/m ² (±5%)	130gr/m ²	



Pamja përpara



Pamja prapa

2. UNIFORMA SHËRBIMI VERORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapelë, këpucë).



Pantallona verore: Pantallona ngjyrë blu e errët. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Ky model shërben edhe për stërvitje.: **Pantallona ngjyrë blu e errët.** Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Ky model shërben edhe për stërvitje. Perberja: 65% poliestër dhe 35% pambuk ($\pm 5\%$),Pesha: 190 ± 10 gr/m² .



Pamja përpara Pamja prapa

Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmishapër

Ngjyra	bojëqielli	
Përbërja %	80 % pambuk($\pm 5\%$)	20 % poliestër ($\pm 5\%$)

Thurja	Tafta 1.1
Masa gr/m ² (± 5 %)	135 gr/m ²



Kapelë tip sportive me ngjyrë blu e errët me stemën e bashkisë në mes dhe mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”.

Me strehe te gjate plastike e veshur me dokun e vet, me perforcim ne kupe, me rrip prapa per rregullimin e gjeresise, ne balle shkruar me qendisje me penj te bardhe ne forme harku’POLICIA BASHKIAKE” dhe poshte qepet sterna e Bashkise.

LËNDA E PARË : TEKSIL RIP STOP përbërje: 50% pambuk dhe 50% poliester +/-3%.

- Masa: 220 gr/m² +/-3gr.
- Ngjyra: Blu e eret
- Qëndrueshmëria në keputje në kg: Në bazë jo me pak se 35, në ind jo me pak se 22.
- Qëndrueshmëria e ngjyrës: Shumë e mirë (nota 5)
- Dëndësia e fijeve në 10 cm: Në bazë 315 +/-6, Ind 214 +/-6%.



Pamja anash	Pamja përpara	Pamja anash
-------------	---------------	-------------

Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa tëvogla. Pjesa poshtë është ngjyrë blu e errët së bashku me jakën, ndërsa pjesa sipër e kaltër. Nëkrahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky mbishkrim është dhenë pjesën prapa.

- Materiali 70% pambuk 30 % polyester.
- Pesha 220 gr/m2
- Qendrueshmëria e ngjyres shumë e mirë (nota 5)

Ne pjesën e përparme të Bluzës të vendoset një velkrof i butë me përmasat 8.5 x 2.8 cm .



Pamja përpara

Pamja prapa

Përdoruesit e biçikletave (pantallona, bluzë, atlete).




- **Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë**, e trikotuar, shoqëruar me ngjyrë blu të errët në pjesën e supeve. Ka dy spaleta për vendosjen e shenjave të supit, e hapur në mes dhe jakë të zezë. Mbyllja përpara bëhet me tri kopsa të vogla. Në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky mbishkrim vendoset dhe në pjesën prapa. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë.. Materiali 70% pambuk 30 % polyester.


- Pesha 220 gr/m²

- Qendrueshmëria e ngjyres shumë e mirë (nota 5)

Ne pjesën e përparme të Bluzës të vendoset një velkrof i butë me përmasat 8.5 x 2.8 cm .

Pantallona të shkurtra ngjyrë blu të errët. Pantallonat kanë dy xhepa të përparmë diagonal, dy xhepa në pjesën e poshtme me kapak ngjyrë të kaltër dhe dy xhepa të pasmë.

Ngjyra	blu e errët
Përbërja % (± 5%)	50% pambuk + 50 % poliamid
Thurja	<p><i>ripstop</i></p> <p>(reps i kombinuar me garniturë 1:1)</p> 
Masa gr/m ²	210 220 gr/m ²
AZO Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm



Pamja përpara

Pamja prapa

Atlete ngjyrë blu të errët me lidhëse.

Të jenë me përbërje të kombinuar lëkure të ndërthur me rrjetë në masën 20-30%. Të kenë lidhëse të cilat kalojnë në vrima të përforcuara me tegela të rregullt me hap të njëjtë, pa grumbullime penjësh dhe me perçina. Këpucët (atletet), të jenë të përshtatshme për vrapim në terrene të hapura, pjesa që prek tokën të jetë prej gome të butë, ku të jetë stampuar dukshëm numri. Tabani nga brenda të jetë i trashë dhe poroz. Atletet të jenë ngjyra të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës. Të paktohen në kuti kartoni të shkruara të dhënat, sipas kërkesave të mësipërme. Numri i këpucës duhet të jetë i dallueshëm.



Jelek fosforeshent ngjyrë e verdhë me dy shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Shiritat janë të vendosur horizontalisht. Në pjesën përpara në krahun e majtë vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”, ndërsa në krahun e djathtë vendoset shenja e gjoksit.

Perberja: 100% polyester, me dukshmeri te larte, sipas standartit SSH/EN ISO 20471 klasi 2 .



3. UNIFORMA CEREMONIALE


Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të gërshetuar përpara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtorin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjës të sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës të sektorit. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.



Drejtuesi Përgjegjësi i sektorit Punonjësi

Ngjyra	blu e errët	
Përbërja ($\pm 5\%$)	50% pambuk	50% poliester
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Pesha ($\pm 5\%$)	200 - 220 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4□5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efkti pilling (kokërrzimi)	nota 4□5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Shiritat janë të gërshetuara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjësin.



Doreza të bardha;



Rrip mesi + rrip krahëqafë e bardhë, tokëz metalike katrore me stemën e bashkisë.

Rrypi i mesit të jetë lëkurë , i bardhë me gjersi 4.5 cm deri në 5 cm. Me tokëz metalike katrore



SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SHENJAVE DALLUESE TË POLICISË BASHKIAKE

Shenjat dalluese të Policisë Bashkiake ndahen si më poshtë:

- a) Shenja e supit;
- b) Shenja e gjoksit;
- c) Shenja e krahut.

Elementet e shenjave dalluese duhet të jenë të rregullta, pa deformime apo shkoputje të konfiguracioneve. Paraqitja, forma dhe përshkrimi i shenjave dalluese të Policisë Bashkiake, janë si më poshtë:

A. SHENJA E SUPIT

Shenjat e supit ngjyrë blu të errët (1 palë) janë në formë spaleti me përmasa 14 cm x 5 cm. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin, me dy shirita ngjyrë argjendi për përgjegjës të sektorit dhe me një shirit të kaltër për punonjës.



Shenjat e supit ngjyrë blu të errët (1 palë) janë në formë spaleti me përmasa 14 cm x 5 cm. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin, me dy shirita ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe me një shirittë kaltër për punonjësin.

- Dok i cilësisë së parë

- Pesha $120 \pm 5 \text{gr/m}^2$;

B. SHENJA E GJOKSIT

Shenja e gjoksit është në formë drejtkëndëshi me përmasa 9 cm x 4 cm. Brenda shenjës vendoset stema e bashkisë dhe numri personal. Shenja vendoset në gjoks në krahun e djathtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësin e sektorit dhe për punonjësin e Policisë Bashkiake.



C. SHENJA E KRAHUT

Shenja e krahut është në formë mburoje me përmasa 8 cm x 6 cm. Shenja përmban stemën e bashkisë dhe mbi të mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Kjo shenjë vendoset në krahun e majtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësin e sektorit dhe punonjësin e Policisë Bashkiake.



Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit: 30 dite kalendarike

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vleftha
1	Pantallona Dimerore	Palë	30	-	-
2	Pantallona verore blu e errët	Palë	30	-	-
3	Pantallona te shkurtra	Palë	16	-	-
4	Këmisha me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër për meshkuj	Copë	60	-	-
5	Kemisha mence te gjata ngjyrë e kaltër	Copë	30	-	-
6	Xhaketa kostumi ngjyrë blu e errët	Copë	30	-	-
7	Xhup blu i errët	Copë	30	-	-
8	Xhiboks	Copë	30	-	-
9	Kepuce uniforme	Palë	30	-	-
10	Bluzë me mëngë të gjata ngjyrë blu e e errët	Copë	30	-	-
11	Bluzë me mëngë të shkurtra bicikleta	Copë	16	-	-
12	Bluzë me mëngë të shkurtra verore	Copë	60	-	-
13	A. Shenja Supit	Palë	30	-	-
14	B. Shenja Gjoksi	Copë	30	-	-
15	C. Shenja Krahut	Copë	30	-	-
16	Kapelë blu e errët ceremoniale	Copë	4	-	-
17	Kapelë blu e errët uniforme	Copë	30	-	-
18	Kapele tip sportive	Copë	30	-	-
19	Kravata blu e errët	Copë	30	-	-
20	Pulovër blu e errët	Copë	30	-	-
21	Bluzë e brendshme dimri e trikotuar,	Copë	30	-	-
22	Këpucë me qafa	Copë	30	-	-
23	Doreza te bardha ceremoniale	Copë	4	-	-
24	Rrip kraheqafe e bardhe	Cope	4		

25	Shirita te gershetuar ceremonial gri	Copë	4		
26	Jelek fosforeshent me logo	Copë	20		
27	Pelerina e shiut	Copë	30		
28	Athlete	Palë	8		
Totali pa T.V.SH					-
TVSH 20%					-
Totali me TVSH					-

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2021,2022 dhe 2023) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht **731,293** (shtatëqind e tridhjetë e njëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.
Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej 365,646 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
 - Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.
2. Operatori ekonomik nese nuk eshte prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për shitje ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emër, e mail). Në rast se do te paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet te vertetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit.
 3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshura me të dhënat teknike për artikujt që oferton. Në katalog, të markohet në menyre të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre.
 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë nga një laborator i akredituar në Republikën e Shqipërisë për artikujt:
 - Xhup
 - Xhaketa kostumi
 - Këmisha
 - Pantallona

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

